

## Rezoluta Nr 5

### Drejtuar: K/Ministrit te Shqiperisë z. Sali Berisha

Per Dijeni: Presidentit te Shqiperise:  
Parlamentit te Shqiperise  
Ministrit te Integritimit  
Parlamentit European  
Banka Boterore  
SIDA  
SNV

Z. Bamir Topi  
Znj.Jozefina Topalli  
Znj Majlinda Bregu

Me date 24 Tetor ne Elbasan u relizua Konferenca Rajonale ku moren pjesë K/Qarkut, Kryetarët e Komunave, Drejtoret e Sherbimit Pyjor, shoqatat dhe Federatat e rajoneve Elbasan si dhe Federatat, Korce, Kukes, Elbasan e Diber, me fokus **Eksperienat e deritanishme dhe sfidat per menaxhimin e pyjeve**. Nga te gjithë diskutimet doli se ne Qarkun e Elbasanit ka pervoja shume pozitive per mbrojtjen dhe kujdesin qe tregohet per pyjet komunale. Hapat e rendesishme per vazhdimin e transferimit te Pyjeve dhe kullotave ne pronesi te Qeverisjes vendore ishte pika me e diskutueshme ne kete konference. Ne kete proces ka arritje si nga Qarku komunat e DSHP. **Konferenca pershendeti hapin qe mori K/Ministri i Shqiperise per reformen me te madhe te ndermarre deri me sot nga Shteti Shqiptar per pyjet dhe kullotat si pjese e reformes se tokes qe filloi ne vitin 1991.**

Krahas arritjeve pjesemarrësit vune ne dukje mangesite per reformen e nisur. Akoma nuk jane njohur kufijte midis fshatrave, midis Komunave por dhe midis rretheve. Perdoruesit nuk kane asnje dokument qe te vertetojne te drejtat e tyre te perdorimit apo pronesise mbi ate pyll, kullote apo te ndonje burimi tjetër natyror. Vetem zyrat e ZRPP në Kruje kanë filluar regjistrimin dhe kerkojne për cdo ngaster pyjore te regjistruar shuma të tilla në leke që komuna nuk mund ti përballojë, ndersa ne Elbasan e gjetkë nuk është regjistruar qofte edhe një ngastër e transferuar në komuna.

Ministria dhe DSHP e rretheve, ndjehen të cliruar nga detyrimi për të ushtruar detyrën për pyjet komunale, cka përbën rrezikun e dëmtimeve masive, pasi për momentin pylli është pa zot, nuk i është njohur e drejta për pyjet dhe kullotat qe jepen ne perdorim apo pronësi fshatit dhe familjeve sepse mungojne dispozitat ligjore. Nuk mund ta zgjidhi problemin VKM nr.22 date 09.01.2008 sepse ligji aktual i pyjeve nuk e lejon zbatimin e tij. Nuk eshte perdorur i njejti kriter per transferimin e pasurise pyjore ne njesite e qeverisjes vendore, duke lënë 4 komuna të Elbasanit pa titull pronësie pa asnjë argument. .

Ministria e Mjedisit i këshillon komunat të marrin specialiste e të krijojnë struktura për menaxhimin e pyjeve. Në fakt taksapaguesait shqiptare mbajnë një shërbim pyjor me taksat e tyre i cili duhet të përshtatet me rrethanat e reja pronësore, ti asistojë komunat si me dokumentacion kadastral e teknik e të zbatojë detyrat e tij, pasi ky shërbim është njësia e specializuar për këtë qëllim. Nëse komunat duhet të marrin ekspertë, këto duhet ti zbriten shërbimit pyjor. Ministri i Mjedisit u pergjigjet perfaqesueseve te shoqatave se nuk do te beje asnje leshim ligjor per te vajtur pylli tek fermeri. Ai shkel ligjin shqiptar, e i kundervihet politikës se qeverise, duke u bere shkak per degradim, dejgie e shkaterrim te nje pasurie te shqiptareve, sic ndodhi me gjithë pyjet Pukës e rretheve te tjera në vitin 2007, ku u dogjën nga mungesa e të zotit mbi 100 mijë hektarë pyje e u raportuan nga Ministri 7 mijë, apo edhe me agrumet e ullinjte ne vitet e para nga lënia jetimë e tyre.

Jemi në një situatë paradoksale. Ligji në fuqi është për pyjet shtetërore. Qeveria ka nxjerrë 327 vendime ku deklarohet transferimi i pyjeve në pronësi të komunave. Ministria e Mjedisit bën spektatorin. Disa komunave si Kastriotit apo Kalasë së Dodës në Dibër, Zall Bastarit në Tiranë, Steblevës, Hotolishtit në Librazhd, Malzi Kukës, Xibër mat e shumë të tjerave u janë dhënë rreth 10 herë më pak se sa ata përdorin. Disa herë dokumentet e transferimit bazohen në të dhënat e inventarit të vitit 1985, pa marrë në konsideratë ndryshimet e mëpasme. Aktualisht komuna ka në dorë një vendim të qeverisë për pyllin, por asgjë tjetër. Ky boshllëk si ligjor dhe institucional mund të kontribuojë në dëm të pyllit të brishtë që mezi po tenton të marrë vehten vitet e fundit. Në pyllin e komunës, reforma duhet të realizohet nga pronarët legjitimë të tij. Strategjia dhe ligji për pyjet duhet të hapin rrugë që pronarët të kenë mundësi të realizojnë zgjidhjet më të mira për kushtet aktuale të tyre. Nëse një banori të Kasharit, pylli i jep më shumë të ardhura duke e kthyer në Park për banorët e Tiranës, ligji duhet tja japë këtë të drejtë Kasharit. Nëse në Pukë ferma pyjore është dominuese, për çdo familje i takon rreth 10 herë më tepër se tokë bujqësore, ai mund të dalë në treg ta zeme me dru zjarri. Tjetër drejtim mund të kërkojë myzeqari apo delvinjoti. Në këtë sfidë historike, të transformimit të pyllit nga pronë e askujt, në pronë të atyre që historikisht e kanë përdorur, ashtu sic po asiston Banka Botërore, Qeveria Suedeze, Federata Europiane e Pyjeve, Organizata Suedeze për Zhvillim SNV, Koalicioni Nderkombëtar i Tokës, e ka për detyrë së pari Ministria e Mjedisit, jo si e shpronësuar e hatërmbetur, por si njerëz të emancipuar që pyllit shqiptar ti japin rritjen që ja kanë dhënë klima e toka, por nuk ja ka lejuar padija njerëzore, dhe ti japin fund historisë së gjatë që nga koha e bizantit të përdorimit informal të burimeve tona natyrore.

Ne **ofrojmë mbështetjen tonë për** konsultimin në të gjithë nivelet, si dhe jemi të gatshëm të marrim pjesë dhe të japim kontributin tonë në procesin e diskutimit të zhvillimit të reformave dhe përmirësimit të kuadrit ligjor për të gjitha resurset Natyrore.

Shqipëria nuk ka pak tokë, por shpërndarja është realizuar padrejtësisht, pasi malësoret në kushtet ku jetojnë disponojnë shumë pak toka bujqësore për të mbijetuar por ama ata mund të kenë dhe të përdorin në mënyrë të qëndrueshme tokat pyjore që i kanë përdorur tradicionalisht e sot nuk u njihen. Ne mendojmë se ka ardhur koha që të integrojmë të gjitha ligjet për burimet Natyrore për një zhvillim të qëndrueshëm të zonave rurale (duke parë në kompleks fermën bujqësore me pyllin, kullotën, tokën bujqësore frutikulturore dhe blegtorinë) për të përcaktuar masa komplekse për zhvillimin rural. Ne shpresojmë dhe një herë në mbështetjen Tuaj për të vazhduar këto reforme aq të rëndësishme për të ardhmen e pyjeve dhe për të zbutur varferinë e zhvilluar zonat rurale e për ta bërë më të bukur Shqipërinë.

**Nga: Federatat rajonale të rrethëve Elbasan, Korce, Kukës, Dibër, Shkoder, Lezhë dhe Shoqata Kombëtare PKKomunal**